

**UDHËZIM**  
**Nr.12, datë 6.6.2011**

**PËR MIRATIMIN E TIPIT TË MJETEVE MOTORIKE ME DY OSE TRI RROTA**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të neneve 71, 72, 74, 75 dhe 76 të ligjit nr.8378, datë 22.7.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, neneve 223, 224, 225, 226, 227, 228, 230, 232 dhe 233 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.153, datë 7.4.2000 “Rregullorja e zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; direktivës 2002/24/KE, datë 18.3.2002 të Parlamentit Europian dhe të Këshillit “Në lidhje me miratimin e tipit të mjeteve motorike me dy ose tri rrota dhe që shfuqizon direktivën e Këshillit 92/61/KEE” dhe të Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit midis Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Europiane dhe shteteve të tyre anëtare, protokollit 5 “Mbi transportin tokësor”, Ministri i Punëve Publike dhe Transportit

UDHËZON:

**KAPITULLI I**  
**OBJEKTI DHE PËRKUFIZIMET**

Neni 1

1. Ky udhëzim, në harmoni të plotë me direktivën 2002/24/KE, zbatohet për të gjitha mjetet motorike me dy ose tri rrota, qoftë me rrota të dyfishta ose ndryshe të synuara për të udhëtuar në rrugë dhe për komponentët ose njësitë e veçanta teknike të këtyre mjeteve motorike.

Ky udhëzim, në harmoni të plotë me direktivën 2002/24/KE, nuk zbatohet për automjetet e mëposhtme:

- a) automjetet me shpejtësi maksimale në kushte të sigurta, jo më shumë se 6 km/orë;
- b) automjetet e synuara për kontrollin e kalimtarëve;
- c) automjetet e synuara për përdorim nga njerëzit me aftësi të kufizuara fizike;
- d) automjetet e synuara për përdorim në gara, rrugë ose në kushte të rrugëve të pashtuara;
- e) automjetet tashmë në përdorim para datës së zbatimit të direktivës 92/61/KEE;
- f) traktorët dhe makinat/makineritë e përdorura për qëllime bujqësore ose qëllime të ngjashme;
- g) automjetet e projektuara kryesisht për përdorim argëtimi në rrugë të pashtuara, të cilat kanë rrota të përshtatura në mënyrë simetrike me një rrotë në pjesën e përparme të automjetit dhe dy rrota në pjesën e prapme;
- h) biçikleta me ndihmën e pedaleve që janë të pajisura me një motor ndihmës elektrik që ka një fuqi maksimale të vazhdueshme nominale prej 0,25 kW, nga e cila rendimenti ulet në mënyrë progresive dhe në fund ndërpritet, ndërsa automjeti arrin një shpejtësi prej 25 km/orë, ose më parë nëse çiklisti ndalon së pedaluari, as për komponentët ose njësitë teknike të tyre, nëse nuk synohen t'i përshtaten automjeteve të mbuluara nga direktiva 2002/24/KE.

Ai nuk zbatohet për miratimin e automjeteve të vetme, përveç kur shtetet anëtare që japin këto miratime pranojnë çdo miratim tip të komponentëve dhe njërive të veçanta teknike të dhëna sipas direktivës 2002/24/KE, në vend të atyre komponentëve dhe njërive të veçanta teknike sipas kërkesave përkatëse kombëtare.

2. Automjetet e përmendura në paragrafin 1 nëndahen në:

a) Ciklomotorët, domethënë automjetet me dy rrota (kategoria L1e) ose automjetet me tri rrota (kategoria L2e) me shpejtësi maksimale në kushte të sigurta prej jo më shumë se 45 km/orë dhe të karakterizuara nga:

- i) në rast të tipit me dy rrota, një motor:
  - kapaciteti cilindrik i të cilit nuk tejkalon 50 cm<sup>3</sup> në rastin e tipit me djegie të brendshme; ose
  - fuqia maksimale nominale nuk është më shumë se 4 kW në rastin e një motori elektrik;

ii) në rastin e tipit me tri rrota, një motor:

- kapaciteti cilindrik i të cilit nuk është më shumë se 50 cm<sup>3</sup> nëse është për shkak të tipit të ndezjes (pozitive); ose

- rendimenti maksimal neto i fuqisë nuk është më shumë se 4 kW në rastin e motorëve të tjerë me djegie të brendshme; ose

- fuqia maksimale e vazhdueshme nominale nuk është më shumë se 4 kW në rastin e një motori elektrik;

b) motomjetet, domethënë automjetet me dy rrota pa kosh (kategoria L3e) ose me kosh (kategoria L4e), të përshtatura me një motor që ka kapacitet cilindrik prej më shumë se 50 cm<sup>3</sup>, nëse për shkak të tipit me djegie të brendshme dhe/ose me shpejtësi maksimale në kushte të sigurta prej më shumë se 45 km/orë,

c) triçiklat, domethënë automjetet me tri rrota të përshtatura simetrikisht (kategoria L5e), të përshtatura me një motor që ka kapacitet cilindrik prej më shumë se 50 cm<sup>3</sup> nëse është për shkak të tipit me djegie të brendshme dhe/ose me shpejtësi maksimale në kushte të sigurta prej më shumë se 45 km/orë.

3. Ky udhëzim, në harmoni të plotë me direktivën 2002/24/KE, zbatohet edhe për katërrotëshet, domethënë mjetet motorike me katër rrota që kanë karakteristikat e mëposhtme:

a) katërrotëshet e lehta, masa e pangarkuar e të cilëve nuk është më shumë se 350 kg (kategoria L6e), pa përfshirë masën e baterive në rastin e automjeteve elektrike, shpejtësia maksimale në kushte të sigurta e të cilave nuk është më shumë se 45 km/orë; dhe

i) kapaciteti cilindrik i të cilave nuk është më shumë se 50 cm<sup>3</sup> për motorët me ndezje (pozitive); ose

ii) rendimenti maksimal neto i të cilëve nuk është më shumë se 4 kW në rastin e motorëve të tjerë me djegie të brendshme; ose

iii) fuqia maksimale e vazhdueshme nominale e të cilëve nuk është më shumë se 4 kW, në rastin e një motori elektrik.

Këto automjete plotësojnë kërkesat teknike të zbatueshme për biçikletat me motor me tri rrota të kategorisë L2e, nëse nuk përcaktohen ndryshe në ndonjë prej direktivave të veçanta;

b) katërrotëshet e ndryshme nga ato të përmendura në (a), masa e pangarkuar e të cilëve nuk është më shumë se 400 kg (kategoria L7e) (550 kg për automjetet e synuara për transportimin e mallrave), pa përfshirë masën e baterive në rastin e automjeteve elektrike dhe fuqia maksimale neto e motorit të të cilëve nuk është më shumë se 15 kW. Këto automjete konsiderohen të jenë triçikla dhe plotësojnë kërkesat teknike të zbatueshme për triçiklat e kategorisë L5e, nëse nuk përcaktohet ndryshe në ndonjë prej direktivave të veçanta.

## Neni 2

Për qëllimet e këtij udhëzimi, në harmoni të plotë me direktivën 2002/24/KE:

1. “Tip automjeti” nënkupton ose një automjet, ose një grup automjesh (variante) që:

a) i përkasin një kategorie të vetme (motoçikleta me dy rrota L1e, triçiklat L2e etj., siç përcaktohet në nenin 1);

b) ndërtohen nga i njëjti prodhues;

c) kanë të njëjtën shasi, strukturë, nënstrukturë, bazament ose strukturë në të cilën bashkëngjiten komponentët kryesorë;

d) kanë një njësi fuqie me të njëjtin parim funksionimi (me djegie të brendshme, elektrike, hibride etj.);

e) kanë të njëjtin tip përcaktimi të dhënë nga prodhuesi.

Një tip automjeti mund të përfshijë variante dhe versione.

2. “Variant” nënkupton ose një automjet, ose një grup automjesh (versione), që janë të të njëjtit tip ku:

a) ato kanë të njëjtën formë karrocierie (karakteristikat kryesore);

b) brenda grupit të automjeteve (versione) ku diferenca në masën me rend kronologjik midis

vlerës më të ulët dhe vlerës më të lartë nuk është më shumë se 20% e vlerës më të ulët;

c) brenda grupit të automjeteve (versione) ku diferenca në masën maksimale të lejueshme midis vlerës më të ulët dhe vlerës më të lartë nuk është më shumë se 20% e vlerës më të ulët;

d) ato kanë të njëjtin cikël funksionimi (dy ose katër goditje, ndezje ose ndezje nën presion);

e) brenda grupit të automjeteve (versione) ku diferenca në kapacitetin cilindrik të njësisë së fuqisë (në rastin e një njësie me djegie të brendshme) midis vlerës më të ulët dhe vlerës më të lartë nuk është më shumë se 30% e vlerës më të ulët;

f) kanë të njëjtin numër dhe përshtatje cilindrash;

g) brenda grupit të automjeteve (versione) ku diferenca në rendimentin e fuqisë të njësisë së fuqisë midis vlerës më të ulët dhe vlerës më të lartë nuk tejkalon 30% të vlerës më të ulët;

h) kanë të njëjtën mënyrë funksionimi (të motorëve elektrikë);

i) kanë të njëjtin tip kutie transmisioni (manuale, automatike etj.).

3. “Version” nënkupton një automjet i të njëjtit tip dhe variant, por që mund të përfshijë ndonjë prej pajisjeve, komponentëve ose sistemeve të renditura në dokumentin informativ në shtojcën II, me kusht që të ketë vetëm:

a) një vlerë të kuotuar për:

i) masën në rendin kronologjik;

ii) masën maksimale të lejueshme;

iii) rendimentin e fuqisë të njësisë së fuqisë;

iv) kapacitetin cilindrik të njësisë së fuqisë; dhe

b) një grup të rezultateve të testeve të kuotuar në përputhje me shtojcën VII.

4. “Sistem” nënkupton çdo sistem automjetesh, si për shembull: frenat, pajisjet e kontrollit të shkarkimit etj., të cilat u nënshtrohet kërkesave të parashtruara në ndonjë prej direktivave të veçanta.

5. “Njësi e veçantë teknike” nënkupton një aparat, si për shembull, një silenciator zëvendësues me sistem shkarkimi, në bazë të kërkesave të një direktive të veçantë, e synuar për të qenë pjesë e një automjeti që mund t’i nënshtrohet miratimit tip veçmas, por vetëm në lidhje me një ose më shumë tipa të specifikuar të automjeteve, kur direktiva e veçantë e parashikon shprehimisht këtë.

6. “Komponent” nënkupton një pajisje/aparat, si për shembull, një fener që i nënshtrohet kërkesave të një direktive të veçantë, të synuar për të qenë pjesë e një automjeti që mund t’i nënshtrohen miratimit tip në mënyrë të pavarur nga një automjet, kur direktiva e veçantë e parashikon shprehimisht këtë.

7. “Miratim tipi” nënkupton procedurën me anë të së cilës një shtet anëtar vërteton se një tip automjeti, sistemi, njësia të veçantë teknike ose komponenti përmbush kërkesat teknike të përcaktuara në direktivën 2002/24/KE ose direktiva të veçanta dhe kontrollet për saktësinë e të dhënave të prodhuesit, siç parashikohen në listën e plotë të parashtruar në shtojcën I.

8. “Rrota të dyfishta” nënkupton dy rrota të montuara në të njëjtin bosht, ku largësia midis qendrave të zonave të tyre të kontaktit me tokën është më pak se 460 mm. Rrotat e dyfishta konsiderohen si një rrotë.

9. “Automjete me shtytje të dyfishtë” nënkupton automjetet me dy sisteme të ndryshme force shtytëse, për shembull, një sistem elektrik dhe një sistem termik.

10. “Prodhues” nënkupton personin ose organin përgjegjës ndaj autoritetit miratues për të gjitha aspektet e procesit të miratimit të tipit dhe për garantimin e përputhshmërisë së prodhimit. Nuk është e rëndësishme që personi ose organi të përfshihet drejtpërdrejt në të gjitha fazat e ndërtimit të automjetit, komponentit ose njësisë së veçantë teknike të mbuluar nga procesi i miratimit.

11. “Shërbim teknik” nënkupton organizatën ose organin që është caktuar si laborator testimi për kryerjen e testeve ose inspektimeve në emër të autoritetit miratues të një shteti anëtar. Ky funksion mund të përmbushet, gjithashtu, nga vetë autoriteti miratues.

## KAPITULLI II PROCEDURAT PËR DHËNIEN E MIRATIMIT TË TIPIT

### Neni 3

Kërkesat për miratimin e tipit i paraqiten nga prodhuesi autoritetit miratues në Republikën e Shqipërisë që, është Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor (DPSHTRR), në zbatim të ligjit “Kodi Rrugor në Republikën e Shqipërisë”. Ato shoqërohen me një dokument informativ, një model i të cilit për qëllime të miratimit të tipit të automjetit përcaktohet në shtojcën II dhe për qëllime të miratimit të tipit të sistemeve, njësive të veçanta teknike ose komponentëve, përfshihet në një aneks ose shtojcë të direktivës së sistemit përkatës, njësisë së veçantë teknike ose komponentit dhe, gjithashtu, nga dokumente të tjera të përmendura në dokumentin informativ. Kërkesat për një tip të caktuar automjeti, sistemi, njësie të veçantë teknike ose komponenti mund të paraqiten vetëm pranë një shteti anëtar.

### Neni 4

1. DPSHTRR-ja, në harmoni të plotë me direktivën 2002/24/KE, jep miratimin e tipit për të gjithë tipat e automjeteve, sistemeve, njësive të veçanta teknike ose komponentëve nëse ato plotësojnë kushtet e mëposhtme:

a) tipi i automjetit plotëson kërkesat teknike të direktivave të veçanta dhe është siç përshkruhet nga prodhuesi, në përputhje me të dhënat e parashikuara në listën e plotë të parashtruar në shtojcën I;

b) sistemi, njësia e veçantë teknike ose komponenti plotësojnë kërkesat teknike të direktivës përkatëse dhe është siç përshkruhet nga prodhuesi, në përputhje me të dhënat e parashikuara në listën e plotë të parashtruar në shtojcën I.

2. Para kryerjes së miratimit të tipit, autoritetet kompetente në shtetin anëtar që kryejnë këto veprime, marrin të gjitha hapat e nevojshëm për të garantuar, nëse është e nevojshme në bashkëpunim me autoritetet kompetente në shtetin anëtar ku zhvillohet prodhimi ose ku produkti silllet në Komunitet, pajtueshmëri me dispozitat e shtojcën VI, me qëllim që automjetet, sistemet, njësitë e veçanta teknike ose komponentët e prodhuar, të hedhur në treg, të ofruar për shitje ose të vënë në shërbim, të përputhen me tipin e miratuar.

3. Autoritetet kompetente të përmendura në paragrafin 2 garantojnë, nëse është e nevojshme, në bashkëpunim me autoritetet kompetente në shtetin anëtar ku zhvillohet prodhimi ose ku produkti silllet në Komunitet, se dispozitat e shtojcën VI vazhdojnë të respektohen.

4. Kur një kërkesë për miratimin e një tipi automjeti shoqërohet me një ose më shumë certifikata të miratimit të tipit të një sistemi, njësie të veçantë teknike ose njësie komponenti të lëshuar nga një ose më shumë shtete anëtare, shteti anëtar që kryen miratimin për një tip automjeti është i detyruar t'i pranojë ato dhe nuk kryen në lidhje me sistemet, njësitë e veçanta teknike dhe/ose komponentët që i janë nënshtruar miratimit të tipit, kontrollet e kërkuara nga paragrafi 1(b).

5. Çdo shtet anëtar është përgjegjës për miratimin e tipit të një sistemi, njësie të veçantë teknike ose komponenti që ai ofron. Autoritetet kompetente në shtetin anëtar që japin miratimin për një tip automjeti kontrollojnë përputhshmërinë e prodhimit, kur është e nevojshme në bashkëpunim me këto autoritete kompetente në shtetet e tjera anëtare, që kanë lëshuar certifikatat e miratimit të tipit për sisteme, njësi të veçanta teknike ose komponentë.

6. Megjithatë, nëse një shtet anëtar konstaton se një automjet, sistem, njësi e veçantë teknike ose komponent që pajtohet me dispozitat e paragrafit 1, është gjithsesi një rrezik serioz për sigurinë e rrugës, ai mund të refuzojë dhënien e miratimit të tipit. Ai informon menjëherë shtetet e tjera anëtare dhe Komisionin në lidhje me këtë, duke deklaruar arsyet në të cilat bazohet vendimi i tij.

### Neni 5

1. Autoriteti kompetent në një shtet anëtar plotëson formularin e miratimit të tipit që përfshihet në shtojcat dhe nënshtojcat III për të gjithë tipat e automjeteve në lidhje me të cilat ai kryen miratimin e tipit dhe përveç kësaj, hyn në rezultatet e testimit sipas titujve përkatës në formularin e bashkëlidhur formularit të miratimit të automjetit, modeli i të cilit jepet në shtojcën VII.

2. Autoriteti kompetent në një shtet anëtar plotëson formularin e miratimit të tipit që përfshihet në një aneks ose shtojcë të çdo direktive të veçantë përkatëse për çdo tip sistemi, njësie të veçantë teknike ose komponenti në lidhje me të cilin ai kryen miratimin e tipit.

3. Certifikatat e miratimit të tipit të një sistemi, njësie të veçantë teknike ose komponenti numërtohen në përputhje me metodën e përshkruar në shtojcën V, pjesa A.

## Neni 6

1. Autoriteti kompetent në çdo shtet anëtar i paraqet, brenda një muaji, autoriteteve të shteteve të tjera anëtare një kopje të certifikatës së miratimit të tipit, së bashku me shtojcat për çdo tip të automjetit që ata kanë miratuar ose kanë refuzuar të miratojnë.

2. Autoriteti kompetent në çdo shtet anëtar i dërgon çdo muaj autoriteteve kompetente të shteteve të tjera anëtare një listë të miratimeve të tipit të një sistemi, njësie të veçantë teknike ose komponenti që ai ka dhënë ose ka refuzuar të japë gjatë atij muaji.

Përveç kësaj, me kërkesën e një autoriteti kompetent të një shteti tjetër anëtar, ai dërgon menjëherë një kopje të certifikatës së miratimit të tipit së bashku me anekset për çdo tip sistemi, njësie të veçantë teknike ose komponenti.

## Neni 7

1. Një certifikatë përputhshmërie, një model i së cilës tregohet në shtojcën IV-A plotësohet nga prodhuesi për çdo automjet të prodhuar në pajtim me tipin që është miratuar. Kjo certifikatë shoqëron çdo automjet. Megjithatë, shtetet anëtare mund të kërkojnë, pas dhënies së një njoftimi të paktën tre muaj përpara Komisionit dhe shteteve të tjera anëtare, për arsyet e taksimit të automjetit ose me qëllim hartimin e dokumentit të regjistrimit të automjetit, që certifikata e përputhshmërisë të përmbajë të dhëna të ndryshme nga ato të përmendura në shtojcën IV-A, me kusht që këto të dhëna të përfshihen qartë në dokumentin informativ.

Certifikata e përputhshmërisë përgatitet në mënyrë të tillë që të parandalojë çdo falsifikim. Për këtë qëllim, printimi bëhet në letër të mbrojtur nga grafika me ngjyra ose me filigran, me shenjën e identifikimit të prodhuesit të automjetit.

2. Një certifikatë përputhshmërie, një model i së cilës tregohet në shtojcën IV-B, plotësohet nga prodhuesi për çdo njësi të veçantë teknike joorigjinale ose komponent të prodhuar në përputhje me tipin e miratuar. Kjo certifikatë nuk kërkohet për njësi ose komponentë të veçantë teknikë origjinalë.

3. Kur njësia e veçantë teknike ose komponenti që duhet t'i nënshtrohet miratimit të tipit, përmbush funksionin e tij/saj ose shfaq një karakteristikë specifike vetëm në lidhje me komponentë të tjerë të automjetit dhe për këtë arsye pajtueshmëria me një ose më shumë kërkesa mund të verifikohet vetëm kur ajo njësi e veçantë teknike ose ai komponent që duhet të miratohet funksionon në lidhje me komponentë të tjerë të automjetit, qoftë realë ose të simuluar, objekti i miratimit të tipit të asaj njësie të veçantë teknike ose komponenti duhet rrjedhimisht të kufizohet. Certifikata e miratimit të tipit për një njësi të veçantë teknike ose komponent përcakton më pas çdo kufizim mbi përdorimin dhe çdo udhëzim për përshtatjen e tij. Pajtueshmëria me këto kufizime dhe kërkesa verifikohen kur automjeti i nënshtrohet miratimit të tipit.

4. Pa cenuar paragrafin 2, mbajtësi i një miratimi të tipit për një njësi të veçantë teknike ose komponent që është dhënë sipas nenit 4 është i detyruar t'i bashkëngjisë çdo njësie të veçantë teknike ose komponenti të prodhuar në përputhje me tipin e miratuar, markën tregtare ose të fabrikës së tij, një deklaratë të tipit dhe nëse direktiva e veçantë e kërkon këtë, markën e miratimit të tipit të përmendur në nenin 8. Në këtë rast, nuk kërkohet që ai të plotësojë certifikatën e parashikuar në paragrafin 2.

5. Çdo mbajtës i certifikatës së miratimit të tipit për një njësi të veçantë teknike ose komponent që sipas paragrafit 3 përmban kufizime mbi përdorimin, duhet të japë informacion të hollësishëm mbi këto kufizime dhe udhëzime që përshtaten, sipas rastit, me çdo njësi të veçantë

teknike ose komponent të prodhuar.

6. Çdo mbajtës i certifikatës së miratimit të tipit për një njësi të veçantë teknike të pajisjes joorigjinale të lëshuar në lidhje me një ose më shumë tipa automjetesh, duhet me çdo njësi të tillë të japë informacion të hollësishëm që lejon identifikimin e këtyre automjeteve.

#### Neni 8

1. Çdo automjet i prodhuar në përputhje me tipin që i është nënshtruar miratimit, mban një markë të miratimit të tipit me përbërje të pajtueshme me seksionin 1, seksionin 3 dhe seksionin 4 të numrit të miratimit të tipit, të përcaktuar në shtojcën V, pjesa A.

2. Çdo njësi e veçantë teknike dhe çdo komponent i prodhuar në përputhje me tipin që i është nënshtruar miratimit përfshin, nëse direktiva e veçantë përkatëse e parashikon këtë, një markë të miratimit të tipit që plotëson kërkesat e përcaktuara në shtojcën V, pjesa B. Numri i miratimit të tipit të renditur në shtojcën V, pjesa B, paragrafi 1.2 është në përputhje me seksionin 4 të numrit të miratimit të tipit të përcaktuar në shtojcën V, pjesa A.

Informacioni në përmbajtje të markës së miratimit të tipit mund të plotësohet me informacion të mëtejshëm që mundëson disa karakteristika, të cilat janë specifike ndaj njësisë së veçantë teknike ose komponentit përkatës që duhet të identifikohet. Ky informacion i mëtejshëm, sipas rastit, specifikohet në direktivat e veçanta mbi ato njësi të veçanta teknike ose komponentë.

#### Neni 9

1. Prodhuesi është përgjegjës për prodhimin e çdo mjete ose prodhimi të çdo sistemi, njësie të veçantë teknike ose komponenti në përputhje me tipin e miratuar. Ndërprerja përfundimtare e prodhimit ose çdo ndryshim në informacionin në përmbajtje të dokumentit informativ, duhet të njoftohet nga mbajtësi i miratimit të tipit autoriteteve kompetente në shtetin anëtar që ka lëshuar atë miratim të tipit.

2. Nëse autoritetet kompetente të shtetit anëtar, të përmendura në paragrafin 1, çmojnë se një ndryshim i këtij tipi nuk përfshin ndonjë ndryshim në certifikatën ekzistuese të miratimit të tipit ose hartimin e një certifikate të re të miratimit të tipit, ata informojnë prodhuesin në mënyrën e duhur.

3. Nëse autoritetet kompetente në shtetin anëtar, të përmendura në paragrafin 1, konfirmojnë se një ndryshim në informacionin e parashtruar në dokumentin informativ, justifikon kontrolle ose teste të reja, ata informojnë prodhuesin në mënyrën e duhur dhe kryejnë këto teste. Nëse kontrollet ose testet përfshijnë ndryshime në certifikatën ekzistuese të miratimit të tipit ose hartimin e një certifikate të re, autoritetet informojnë autoritetet kompetente të shteteve të tjera anëtare në përputhje me nenin 6.

4. Kur të dhënat që shfaqen në dokumentin informativ për miratimin e automjetit kanë ndryshuar, prodhuesi i dërgon faqe të rishikuara autoritetit miratues, të cilat tregojnë qartë natyrën e ndryshimit dhe datën e rilëshimit. Vetëm kur ndryshimet e bëra në dokumentin informativ kanë nevojë për ndryshimin e një ose më shumë informacioneve të dhëna në certifikatën e përputhshmërisë në shtojcën IV (me përjashtim të pikave 19.1 dhe 45 deri 51, përfshirë kjo e fundit), numri i referencës në dokumentin informativ duhet të ndryshohet.

5. Kur një certifikatë e miratimit të tipit pushon së pasuri efekt si rezultat i ndërprerjes përfundimtare të prodhimit të tipit të automjetit që është miratuar ose të sistemit ose njësisë së veçantë teknike ose komponentit që i është nënshtruar miratimit të tipit, autoritetet kompetente në shtetin anëtar që kanë kryer miratimin e tipit informojnë brenda një muaji autoritetet kompetente në shtetet e tjera anëtare.

#### Neni 10

1. Nëse shteti anëtar që ka kryer miratimin e tipit konstaton se automjetet, sistemet, njësitë e veçanta teknike ose komponentët nuk pajtohen me tipin e miratuar, ai merr masat e nevojshme për të garantuar se prodhimi i çdo artikulli që është miratuar, është sërish i përputhshëm. Autoritetet kompetente në atë shtet anëtar informojnë autoritetet në shtetet e tjera anëtare në lidhje me masat e

marra, të cilat, kur është e nevojshme, mund të shtrihen në tërheqjen e miratimit të tipit.

2. Nëse një shtet anëtar konstaton se automjetet, sistemet, njësitë e veçanta teknike ose komponentët nuk pajtohen me tipin e miratuar, ai mund t'i kërkojë shtetit anëtar që ka kryer miratimin të verifikojë parregullsitë e konstatuara. Shteti anëtar që ka bërë miratimin e tipit kryen kontrollet e nevojshme brenda gjashtë muajve pas datës së marrjes së kësaj kërkesë. Në rast mospajtueshmërie, shteti anëtar që ka kryer miratimin e tipit marrin masat e përcaktuara në paragrafin 1.

3. Autoritetet kompetente në shtetet anëtare informojnë njëri-tjetrin brenda një muaji në lidhje me tërheqjen e çdo miratimi të tipit të dhënë dhe mbi arsyet për një masë të tillë.

4. Nëse shteti anëtar që ka dhënë miratimin e tipit kundërshton mospajtueshmërinë e njoftuar atij, shtetet anëtare të përfshira përpiqen të zgjidhin çështjen. Komisioni informohet dhe kur është e nevojshme, zhvillon konsultimet e duhura me qëllim arritjen e një zgjidhjeje.

#### Neni 11

Duke vepruar me shumicë të cilësuar mbi një propozim nga Komisioni, Këshilli mund të pranojë barasvlershmërinë midis kushteve ose dispozitave për miratimin e tipit të automjeteve, sistemeve, njësive të veçanta teknike dhe komponentëve të krijuar nga direktiva 2002/24/KE, së bashku me direktivat e veçanta dhe procedurat e krijuara nga rregulloret ndërkombëtare ose rregulloret e vendeve të treta në kuadër të marrëveshjeve shumëpalëshe ose dypalëshe ndërmjet Komunitetit dhe vendeve të treta.

#### Neni 12

Nëse një shtet anëtar konstaton se automjetet, sistemet, njësitë e veçanta teknike ose komponentët përbëjnë rrezik për sigurinë në rrugë, megjithëse janë të një tipi të përshtatshëm, për një periudhë maksimale prej gjashtë muajsh, ai mund të ndalojë në territorin e tij shitjen, hyrjen në shërbim ose përdorimin e tyre. Ai informon menjëherë shtetet e tjera anëtare, duke dhënë arsyet për vendimin e tij.

#### Neni 13

Çdo vendim në lidhje me refuzimin ose tërheqjen e miratimit të tipit, një ndalim mbi shitjen ose përdorimin e një automjeti, njësie të veçantë teknike ose komponenti, i marrë në përputhje me dispozitat e miratuara në zbatim të direktivës 2002/24/KE, deklaron hollësisht arsyet mbi të cilat është bazuar. Ai i njoftohet palës përkatëse, e cila në të njëjtën kohë informohet për mjetet ligjore të vëna në dispozicion sipas ligjeve në fuqi në shtetet anëtare dhe për afatet kohore të lejuara për ushtrimin e këtyre mjeteve ligjore.

#### Neni 14

1. Shtetet anëtare njoftojnë Komisionin dhe shtetet anëtare për emrat dhe adresat e:

a) autoriteteve të miratimit të tipit dhe nëse është e zbatueshme, disiplinat për të cilat autoritetet janë përgjegjëse;

b) shërbimet teknike që ata kanë miratuar, duke specifikuar për cilat procedura testimi është miratuar secili prej këtyre shërbimeve. Shërbimet e njohura duhet të përmbushin standardet e harmonizuara mbi funksionimin e laboratorëve të testimit (EN 45001) në bazë të kushteve të mëposhtme:

i) një prodhues nuk mund të miratohet si shërbim teknik kur direktiva e veçantë e parashikon shprehimisht këtë;

ii) për qëllim të direktivës 2002/24/KE, nuk konsiderohet përjashtuese për një shërbim teknik përdorimi i pajisjes nga një burim i jashtëm, në bazë të marrëveshjes së autoritetit miratues.

Një shërbim i njohur supozohet të përmbushë standardin e harmonizuar, por sipas rastit, Komisioni mund t'i kërkojë shteteve anëtare të sigurojnë prova mbështetëse.

2. Shërbimet e vendeve të treta nuk mund të njihen si shërbime të miratuara teknike përveçse në kuadër të marrëveshjeve dypalëshe ose shumëpalëshe ndërmjet Komunitetit dhe vendeve të treta.

### KAPITULLI III KUSHTET E LIDHURA ME LËVIZJEN E LIRË, MASAT E PËRKOHSHME, PËRJASHTIMET DHE PROCEDURAT ALTERNATIVE.

#### Neni 15

1. Shtetet anëtare nuk ndalojnë hedhjen në treg, shitjen, hyrjen në shërbim ose përdorimin e automjeteve të reja që pajtohen me direktivën 2002/24/KE. Vetëm automjetet që pajtohen me direktivën 2002/24/KE mund të paraqiten për regjistrim fillestar.

2. Shtetet anëtare nuk ndalojnë hedhjen në treg, shitjen ose përdorimin e njësive të reja të veçanta teknike ose komponentëve të rinj që pajtohen me direktivën 2002/24/KE. Vetëm njësitë e veçanta teknike dhe komponentët që pajtohen me direktivën 2002/24/KE, mund të hidhen në treg dhe shiten për herë të parë për përdorim në Republikën e Shqipërisë.

3. Duke devijuar nga paragrafët 1 dhe 2:

a) Shtetet anëtare mund të përjashtojnë automjetet, sistemet, njësitë e veçanta teknike dhe komponentët e synuar:

i) ose për prodhimin në seri të vogla, deri maksimumi 200 njësi në vit për tip automjeti, sistem, komponent ose njësi të veçantë teknike;

ii) ose për forcat e armatosura, agjencitë e zbatimit të ligjit, shërbimet e mbrojtjes civile, brigadat e zjarrfikëses ose organet e punëve publike, nga pajtueshmëria me ndonjë prej kërkesave të direktivave të veçanta.

Shtetet e tjera anëtare informohen për këto përjashtime brenda një muaji nga dhënia e tyre. Brenda tre muajve këto shtete anëtare vendosin nëse do të pranojnë miratimin e tipit për automjetet që duhet të regjistrohen brenda territorit të tyre. Certifikata e këtij miratimi të tipit nuk mund të mbajë titullin “certifikata e miratimit të tipit KE”.

b) Certifikatat e miratimit të tipit, të lëshuara në nivel kombëtar para datës 17 qershor 1999, mbeten të vlefshme brenda shteteve anëtare që i lëshojnë ato për një periudhë prej katër vitesh nga data në të cilën ligjet kombëtare duhet të pajtohen me direktivat përkatëse.

E njëjta periudhë shtrihet, gjithashtu, për tipat e automjeteve, sistemeve, komponentëve ose njësive teknike që pajtohen me kërkesat kombëtare të shteteve anëtare, të cilat zbatojnë sisteme legjislative të ndryshme nga ato për miratimin e tipit në fuqi para zbatimit të direktivave përkatëse.

Automjetet e trajtuara nga përjashtimi i fundit mund të hidhen në treg, shiten ose hyjnë në shërbim gjatë kësaj periudhe pa afat në përdorimin e tyre.

Hedhja në treg, shitja dhe përdorimi i sistemeve, njësive të veçanta teknike dhe komponentëve për këto automjete nuk kanë afat kohor.

4. Direktiva 2002/24/KE, nuk cenon të drejtën e shteteve anëtare për të parashtruar, në përputhje me Traktatin, kërkesat që ata i konsiderojnë të nevojshme për të garantuar mbrojtjen e përdoruesve gjatë përdorimit të automjeteve në fjalë, me kusht që kjo të mos përfshijë modifikime në automjete.

#### Neni 16

1. Duke devijuar nga neni 15(1) dhe (2) dhe brenda afateve kohore të përcaktuara në shtojcën VIII, shtetet anëtare, për një periudhë të kufizuar kohe, mund të regjistrojnë dhe lejojnë shitjen ose hyrjen në shërbim të automjeteve të reja që pajtohen me një tip automjeti miratimi i tipit i të cilit nuk është më i vlefshëm. Ky opsion kufizohet për një periudhë prej 12 muajsh që nga data në të cilën miratimi i tipit ka humbur vlefshmërinë.

Nënparagrafi i parë zbatohet vetëm për automjetet që kanë qenë në territorin e Komunitetit dhe shoqëroheshin nga një certifikatë e vlefshme përputhshmërie, e cila është lëshuar kur miratimi i tipit i automjetit në fjalë ka qenë ende i vlefshëm, por që nuk është regjistruar ose vënë në shërbim para se miratimi i tipit i lartpërmendur të humbte vlefshmërinë.



2. Para se paragrafi 1 të mund të zbatohet për një ose më shumë tipa të një kategorie të caktuar, me hyrjen në shërbim të këtyre tipave automjeteve prodhuesi i paraqet një kërkesë autoritetit kompetent të çdo shteti anëtar përkatës. Kërkesa specifikon arsyet teknike dhe/ose ekonomike që e justifikojnë atë.

Brenda tre muajve këto shtete anëtare vendosin nëse dhe për sa njësi ato do të pranojnë tipin e automjetit përkatës për regjistrim në territorin e tyre. Çdo shtet anëtar përkatës, deri në hyrjen në shërbim të këtyre tipave automjeteve, është përgjegjës për të garantuar që prodhuesi të respektojë dispozitat e aneksit VIII. Shtetet anëtare i dërgojnë Komisionit çdo vit një listë të përjashtimeve të dhëna.

3. Për sa u përket automjeteve, komponentëve ose njësive të veçanta teknike që përfshijnë teknologji ose koncepte që, për shkak të natyrës së tyre specifike, nuk mund të pajtohen me një ose më shumë kërkesa të një ose më shumë prej direktivave të veçanta, zbatohet pika (c) e nenit 8(2) të direktivës 70/156/KEE.

#### KAPITULLI IV PROCEDURA PËR PËRSHTATJEN NDAJ PROGRESIT TEKNIK

##### Neni 17

Çdo amendim i nevojshëm për qëllimet e përshtatjes ndaj progresit teknik të anekseve të direktivës 2002/24/KE ose dispozitave të direktivave të veçanta të përmendura në shtojcën I, miratohen në përputhje me procedurën e përcaktuar në nenin 18(2).

##### Neni 18

1. Komisioni asistohet nga Komiteti për Përshtatjen ndaj Progresit Teknik, i krijuar në bazë të nenit 13 të direktivës 70/156/KEE (në vijim i referuar si “Komiteti”).

2. Kur referohet ky paragraf, zbatohen nenet 5 dhe 7 të vendimit 1999/468/KE, duke pasur parasysh dispozitat e nenit 8 të tij.

Periodha e përcaktuar në nenin 5(6) të vendimit 1999/468/KE caktohet në tre muaj.

3. Komiteti miraton rregullat e tij të procedurës.

#### KAPITULLI V DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

##### Neni 19

Direktiva e Këshillit 92/61/KEE shfuqizohet me efekt që nga 9 nëntori 2003. Referencat e bëra ndaj direktivës 92/61/KEE interpretohen si referenca ndaj direktivës 2002/24/KE dhe lexohen sipas tabelës së ndërlidhjes në shtojcën IX.

##### Neni 20

1. Shtetet anëtare sjellin në fuqi para 9 majit 2003, ligjet, rregulloret dhe dispozitat administrative të nevojshme që duhet të pajtohen me direktivën 2002/24/KE. Ato informojnë menjëherë Komisionin në lidhje me këtë.

Gjatë miratimit të këtyre masave nga shtetet anëtare, ato i referohen direktivës 2002/24/KE ose shoqërohen nga kjo referencë në lidhje me botimin e tyre zyrtar. Metodatat e bërjes së kësaj reference përcaktohen nga shtetet anëtare.

2. Shtetet anëtare zbatojnë dispozitat e përmendura në paragrafin 1, nënparagrafi i parë, që

nga 9 nëntori 2003. Megjithatë, me kërkesë të prodhuesit modeli i mëparshëm i certifikatës së përputhshmërisë mund të përdoret ende për 12 muaj më pas.

3. Nga 9 maji 2003 shtetet anëtare nuk ndalojnë hyrjen e parë në shërbim të automjeteve që pajtohen me direktivën 2002/24/KE.

4. Shtetet anëtare i komunikojnë Komisionit tekstet e dispozitave kryesore të ligjit kombëtar që ato miratojnë në fushën e mbuluar nga direktiva 2002/24/KE.

#### Neni 21

DPSHTRR-ja, në harmoni të plotë me direktivën 2002/24/KE, do të pranojë kërkesa për miratimin e tipit KE kur Republika e Shqipërisë të jetë shtet anëtar.

Direktiva 2002/24/KE nuk zhvlerëson asnjë miratim të dhënë para 9 nëntorit 2003, as nuk pengon zgjerimin e këtyre miratimeve sipas kushteve të direktivës sipas së cilës ato janë dhënë fillimisht. Megjithatë, që nga 9 nëntori 2004 certifikatat e përputhshmërisë të lëshuara nga prodhuesi pajtohen me modelin e përcaktuar në shtojcën IV.

#### Neni 22

Deri në harmonizimin e sistemeve të regjistrimit dhe tatimit në shtetet anëtare në lidhje me automjetet e mbuluara nga direktiva 2002/24/KE, shtetet anëtare mund të përdorin sisteme të kodit kombëtar, me qëllim lehtësimin e regjistrimit dhe tatimit në territorin e tyre. Shtetet anëtare mund të kërkojnë, gjithashtu, që certifikata e përputhshmërisë të plotësohet nga numri i kodit kombëtar.

#### Neni 23

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT  
**Sokol Olldashi**